



## UDHEZUES I PERDORUESIT PER INCIDENTET E SIGURISE

**Në zbatim të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “MBI MASAT TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE PER TE GARANTUAR SIGURINE DHE INTEGRITETIN E RRJETEVE DHE/OSE SHERBIMEVE TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”, shoqëria “BLETA” SHPK, publikon këtë udhëzues për përdoruesit “**Rreth incidenteve më të zakonshme të sigurisë, veprimeve dhe/ose mjeteve që duhen ndjekur për të parandaluar ndodhjen e këtyre incidenteve dhe veprimeve që duhen ndjekur pas ndodhjes së incidenteve të sigurisë**”**

Udhëzues me qëllim mbrojtjen e përdoruesve të komunikimeve elektronike nga aktivitete me natyrë mashtruese.

1. Mbajeni softwarin operativ të kompjuterit tuaj gjithmone të updatuar, kjo ju mundeson të siguroheni nga threats me të fundit.
2. Aktivizoni gjithmone firewall, antivirus apo programe si anti spyware, anti malware, trojan etj...
3. Krijoni fjalekalim të fortë për çdo llogari tuaj. Fjalekalimi duhet të përmbajë të paktën 8 karaktere, ndër të cilat numra, gërma të mëdha dhe të vogla si edhe simbole. Mundohuni mos të përdorni të njëjtin fjalekalim për çdo llogari. Ndryshoni të paktën një herë në 3 muaj fjalekalimin. Fjalekalimi nuk duhet të ndahet me të tjerë. Shembull i një fjalekalimi: Wery!34@oRTe?
4. Eliminoni programe të panevojshme, kujdes gjatë instalimit të një programi që ju duhet mund të instalohen programe të tjera të panevojshme që cenojnë sigurinë e sistemit. Lexoni mirë çdo tabelë që ju del gjatë instalimit të një programi dhe c’aktivizoni opsionet e pa dëshiruara.
5. Kujdes gjatë navigimit tuaj në internet, shfletoni vetëm faqet për të cilat jeni të sigurtë, mos klikoni në linqe që ju shfaqen gjatë navigimit me mesazhe mashtruese.
6. Mos shkarkoni dhe të instaloni nga Interneti asgjë pa e ditur se çfarë është, pjesa më e madhe janë viruse.

7. Mos hapni email kur nuk njihni derguesin, apo email te formes “ju jeni fitues, ju jeni perzgjedhur” etj... Email qe kerkojne informacion per te dhenat tuaja personale, si emer mbiemer, adrese, karte krediti, numra llogarie, password etj..
8. Ruhuni nga telefonata mashtruese, mos merrni numra te cilet nuk i njihni pasi mund tju tarifojne shume shtrenjte.
9. Kini shume kujdes tek rrjetet sociale si facebook, instagram etj.. Zgjidhni mire se cilet mund te shohin profilin tuaj, kontrolloni me kujdes kerkesat per shok apo ndjekes.
10. Mos publikoni foto tuajat apo te femijeve tuaj dhe vendondhjen
11. Mundohuni te merni sa me shume informacion ne lidhje me kompiuterat, internetin, rrjetet sociale dhe cdo gje qe ndodhet online.
12. Ruajini femijet tuaj nga perdorimi i kompiuterit pa kontroll, komunikoni me to cfare bejne online, vendoseni kompiuterin ne nje vend te dukshem, mbani te gjitha te dhenat e femijes suaj online(login, password)
13. Konsideroni perdorimin e programeve per manaxhimin e Kompjuterave/Internetit:
  - a. Nivele aksesit sipas moshes – Kjo lejon vendosjen e disa niveleve te aksesit per antaret e familjes.
  - b. Filtrimi dhe Bllokimi (hyres apo dales)
  - c. Kufizimet me orar te perdorimit (nepermjet Firewall te modemit)
  - d. Prinderit mund te shikojne te dhena (log) qe detajojne faqet e vizituara, faqet e bllokuara, sesione chat-i, etj

Bleta Sh.p.k  
Lagjia 1, Rruga Taulantia, Durres

Tel: +355 52 800808  
E-Mail: [info@bleta.net](mailto:info@bleta.net)  
Web-site: [www.bleta.net](http://www.bleta.net)

